



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETEROR I ZGJEDHJEVE

Data:

Nr:

Ora:

PROJEKTVENDIM

PËR

**SHPËRNDARJEN E MANDATEVE NDËRMJET SUBJEKTEVE ZGJEDHORE PËR KËSHILLIN E BASHKISË,
BASHKIA POLIÇAN, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja "i", e 2, nenet 162 dhe 166, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve,

VËREN:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja "i", të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve miraton shpërndarjen e mandateve në zgjedhjet për këshillat vendorë, si dhe jep mandatet për çdo kryetar bashkie, territori i të cilave është ndarë në më shumë se një ZAZ.

Komisioni Zonal i Administrimit Zgjedhor, me vendimin nr. 148, datë 15.5.2023, ka miratuar Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit për Këshillin e Bashkisë Poliçan. Kundër vendimit të sipërcituar të KZAZ nuk rezulton të jetë bërë ankim.

Në bazë të nenit 162, pika 1, dhe 166, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve përllogarit shpërndarjen e mandateve për çdo zonë zgjedhore.

Rezultati për Këshillin e Bashkisë Poliçan për subjektet zgjedhore është si tabela nr.1 më poshtë.

(Tabela 1)

Nr. FV	Subjekti Zgjedhor	Vota	Perqindja
1	Bashkë Fitojmë	487	10,32 %
2	Partia Socialiste e Shqipërisë	3355	71,08 %
3	Partia Agrare Ambjentaliste e Shqipërisë	199	4,22 %

Data: . . 2023 Nr:

Ora:



"Për shpërndarjen e mandateve ndërmjet subjekteve zgjedhore për Këshillin e Bashkisë, Bashkia Poliçan për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023"

4	Partia Republikane Shqiptare	50	1,06 %
6	Partia Demokracia Sociale	101	2,14 %
8	Partia Socialdemokrate	67	1,42 %
9	Partia Demokratike	280	5,93 %
22	Partia Unitetit Kombetar	181	3,83 %
	Totali	4720	100 %

Në bazë të nenit 162, pika 2, numri i votave të vlefshme në nivel zone zgjedhore të secilit subjekt pjesëtohet në mënyrë të vazhdueshme me numra natyrorë të njëpasnjëshëm, të quajtur pjesëtues, duke filluar me numrin 1 dhe duke përfunduar me numrin natyror 15 (pesëmbëdhjetë) që i korrespondon numrit të mandateve që shpërndahen në zonën zgjedhore Bashkia Poliçan, në bazë të shkresës nr. 157/1./2., prot, datë 24.02.2023, të Prefektit të Qarkut Berat.

Herësit e përfituar nga ky pjesëtim janë në tabelën nr. 2 bashkëlidhur.

Sipas nenit 162, pika 4, herësit e përftuar nga çdo pjesëtim renditen në listë nga herësi më i madh tek ai më i vogël, duke renditur përkrah tyre subjektin, të cilit i përket herësi përkatës. Renditja vazhdon derisa të renditen aq herës sa është numri i mandateve që shpërndahen në zonën zgjedhore përkatëse, pra 15 (pesëmbëdhjetë). Nga kjo renditje marrim rezultatin si në tabelën nr. 3, më poshtë.

(Tabela 3)

Nr.	Heresi	Subjekti
1	3355	Partia Socialiste e Shqipërisë
2	1677	Partia Socialiste e Shqipërisë
3	1118	Partia Socialiste e Shqipërisë
4	838	Partia Socialiste e Shqipërisë
5	671	Partia Socialiste e Shqipërisë
6	559	Partia Socialiste e Shqipërisë
7	487	Bashkë Fitojmë
8	479	Partia Socialiste e Shqipërisë
9	419	Partia Socialiste e Shqipërisë
10	372	Partia Socialiste e Shqipërisë
11	335	Partia Socialiste e Shqipërisë
12	305	Partia Socialiste e Shqipërisë
13	280	Partia Demokratike
14	279	Partia Socialiste e Shqipërisë
15	258	Partia Socialiste e Shqipërisë

Në bazë të nenit 162, pika 5, të Kodit Zgjedhor, një subjekt zgjedhor përfiton një numër mandatesh të barabartë me numrin e herësve të përfshirë në listën e përcaktuar më sipër.

Data: . . 2023 Nr:
Ora:



“Për shpërndarjen e mandateve ndërmjet subjekteve zgjedhore për Këshillin e Bashkisë, Bashkia Poliçan për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”

Nga kryerja e veprimeve të mësipërme marrim rezultatin për shpërndarjen e mandateve si në tabelën nr. 4, më poshtë.

(Tabela 4)

Nr.	Subjekti Zgjedhor	Mandate
1	Bashkë Fitojmë	1
2	Partia Socialiste e Shqipërisë	13
3	Partia Demokratike	1

Sipas nenit 163, pika 1 dhe të nenit 166, pika 3, të Kodit Zgjedhor, menjëherë pas përfundimit të llogaritjes së rezultatit si më sipër, KQZ-ja përlllogarit shpërndarjen e mandateve për kandidatët fitues për secilin subjekt, në bazë të renditjes në listat shumëmemërore të subjekteve zgjedhore të miratuara nga Komisioni Zonal i Administrimit Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “i”, e 2, nenin 162 dhe nenin 166, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOS:

1. Shpërndarjen e mandateve për subjektet zgjedhore në zonën zgjedhore Bashkia Poliçan, si më poshtë:

Subjekti Zgjedhor	Mandate
Bashkë Fitojmë	1
Partia Socialiste e Shqipërisë	13
Partia Demokratike	1

2. Shpalljen e kandidatëve fitues nga listat shumëmemërore të subjekteve zgjedhore, të miratuara nga Komisioni Zonal i Administrimit Zgjedhor, për Këshillin e Bashkisë Poliçan, si më poshtë:

Bashkë Fitojmë

1 Hajredin Ismail Dervishi

Partia Socialiste e Shqipërisë

1 Astrit Skender Hasa

2 Mimoza Myftar Lulaj

Data: . . 2023 Nr:
Ora:



“Për shpërndarjen e mandateve ndërmjet subjekteve zgjedhore për Këshillin e Bashkisë, Bashkia Poliçan për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”

3	Hajri	Xhevit	Bregu
4	Ermiona	Thoma	Taho
5	Adriatik	Ismail	Dashi
6	Ariana	Adil	Hasanaj
7	Refat	Ali	Spahiu
8	Sabrie	Faslli	Çelaj
9	Admir	Flamur	Pupa
10	Sidorela	Bujar	Saliasi
11	Krenar	Avdyl	Koxhaj
12	Luljeta	Muhamet	Qama
13	Haki	Flamur	Meçe

Partia Demokratike

1	Namik	Zane	Alizoti
---	-------	------	---------

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI